



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Kryesia e Kuvendit

P-006

Prishtinë, më 20 nëntor 2017, në orën 15:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 20 NËNTOR 2017

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Aida Dërguti, Kujtim Shala, Slavko Simiq dhe Mufera Shinik, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Albulena Haxhiu, Armend Zemaj, Elmi Reçica, Sasha Milosavljeviq, Ahmet Isufi dhe Albert Kinolli.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Valmir Klaiqi.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Shefki Shoshaj, Musli Krasniqi dhe Osman Shatri.

Nga OSBE-ja: Sanije Berisha,

Nga EUSR-ja: Blerta Bejtullahu dhe

Nga NDI-ja: Rinor Beka.

Mbledhjen e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mëparshme,
2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, e mbajtur më 23 tetor 2017

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, e mbajtur më 23 tetor 2017.

2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet për seancë plenare, me pëlqimin e përfaqësuesve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare e Kuvendit të mbahet të enjten, më 23 nëntor 2017, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. *Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*
2. *Koha për pyetje parlamentare,*
3. *Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme,*
4. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-31 për lirinë fetare në Kosovë,*
5. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kryeqytetin e Republikës së Kosovës/Prishtinën,*
6. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tatimin në pronën e paluajtshme,*
7. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/26 për trashëgiminë në Kosovë,*
8. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës,*
9. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-007 për procedurën jokontestimore,*
10. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndërmjetësim,*
11. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shoqëritë tregtare,*

12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për standardizim,
13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-072 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-214,
14. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për infrastrukturën kritike,
15. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Noterinë,
16. Rekomandimi i Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Medie për shkarkimin e një anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës,
17. Shqyrtimi i raportit vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2016,
18. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016,
19. Shqyrtimi i raportit vjetor për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike në sektorin publik të Kosovës për vitin 2016,
20. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga komuniteti serb,
21. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Bordit për Ankesa,
22. Zgjedhja e një (1) anëtari të Komisionit të Pavarur të Medieve,
23. Zgjedhja e dy (2) anëtarëve të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës.

* * *

Gjithashtu, Kryesia lidhur me pikën 20 dhe 21 të lartcekura të rendit të ditës, nxori edhe këto përfundime:

I. P Ë R F U N D I M

1. Kërkohet nga grupet parlamentare të Kuvendit që deri në seancën e radhës, më 23 nëntor 2017, t'i propozojnë deputetët për kryetar, zëvendëskryetar të parë dhe të dytë, si dhe për anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga komuniteti serb.
2. Përbërja e Komisionit ad hoc do të jetë, si në vijim: GP i LVV-së, 3 anëtarë; GP i LDK-së, kryetarin dhe 1 anëtar; GP i PDK-së, zëvendëskryetarin e parë dhe 1 anëtar; GP i Listës Serbe, zëvendëskryetarin e dytë; GP AAK-së 1 anëtar; GP "Nisma për Kosovën", 1 anëtar dhe GP "6+", 1 anëtar.

II. P Ë R F U N D I M

1. Kërkohet nga grupet parlamentare të Kuvendit që deri në seancën e radhës, më 23 nëntor 2017, t'i propozojnë deputetët për kryetar, zëvendëskryetar të parë dhe të dytë, si dhe për anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Bordit për Ankesa.

2. Përbërja e Komisionit ad hoc do të jetë, si në vijim: GP i LVV-së, zëvendëskryetarin e parë dhe 2 anëtarë; GP i LDK-së, 2 anëtarë; GP i PDK-së, kryetarin dhe 1 anëtar; GP i Listës Serbe, 1 anëtar; GP i AAK-së, 1 anëtar; GP "Nisma për Kosovën", 1 anëtar dhe GP "6+", zëvendëskryetarin e dytë.

3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave

1. Emërimi i anëtarëve në Forumin për Transparencë Parlamentare

Kryesia lidhur me pikën e lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

I. Emërohen anëtarët në Forumin për Transparencë Parlamentare, si në vijim:

1. Deputetja Shqipe Pantina, nga GP i Lëvizjes Vetëvendosje,
2. Deputeti Driton Selmanaj, nga GP i Lidhjes Demokratike të Kosovës,
3. Deputeti Zenun Pajaziti, nga GP i Partisë Demokratike të Kosovës,
4. Deputetja Jelena Bontiq, nga GP i Listës Serbe,
5. Deputetja Teuta Haxhiu, nga GP i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës,
6. Deputetja Albulena Balaj-Halimaj, nga GP "Nisma për Kosovën" dhe
7. Deputeti Fikrim Damka, nga GP "6+",
8. Shqipe Krasniqi, zyrtare e Administratës së Kuvendit,
9. Fehmi Hyseni, zyrtar i Administratës së Kuvendit,
10. Vullnet Kabashi, zyrtar i Administratës së Kuvendit,
11. Musli Krasniqi, zyrtar i Administratës së Kuvendit,
12. Albert Krasniqi, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI),
13. Visar Rushiti, Instituti GAP,
14. Valmir Ismaili, "D+",
15. Burim Ejupi, Instituti INDEP.

2. Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve të delegacionit të Kuvendit të Shqipërisë që e ka vizituar Kosovën

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet kërkesa për mbulimin e shpenzimeve të akomodimit, si dhe shpenzimeve tjera të dala me rastin e pritjes së delegacionit katër (4) anëtarësh, i udhëhequr nga z. Gramoz Ruçi, Kryetar i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për vizitën e realizuar në Kosovë, nga data 5-7 nëntor 2017.

3. Kërkesa për emërimin e delegacionit të përhershëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës në Asamblenë Parlamentare të Procesit të Bashkëpunimit për Evropën Juglindore (SEECp) për Legjislaturën e VI

Kryesia e miratoi kërkesën për emërimin e delegacionit të përhershëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës në Asamblenë Parlamentare të Procesit të Bashkëpunimit për Evropën Juglindore (SEECp) për Legjislaturën VI.

Përbërja e delegacionit do të jetë në përputhje me propozimet e komisioneve përkatëse, sipas kërkesës adresuar Kryesisë së Kuvendit.

4. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar të tetë (8) deputetëve të Kuvendit të Kosovës në Francë

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Saranda Bogujevci, Valentina Bunjaku- Rexhepi, Andin Hoti, Shkumbin Demaliaj, Igor Simić, Albulena Balaj-Halimaj, Bahrim Shabani dhe Islam Pacolli u lejohej udhëtimi zyrtar për të marrë pjesë në vizitën studimore e cila do të mbahet në Strasburg, Francë, nga data 21-24 janar 2018.

2. Shpenzimet e udhëtimit, të akomodimit (me tejkallim në bazë të rezervimit paraprak) dhe mëditjet për të lartshënuarit në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës, ndërsa nga Parlamenti Evropian do të rimbursohen shpenzimet e udhëtimit dhe të akomodimit.

5. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Itali të nënkryetarit të Kuvendit, Xhavit Haliti dhe deputetit, Slobodan Petroviq

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Nënkryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Xhavit Haliti dhe deputetit z. Slobodan Petroviq, u lejohej udhëtimi zyrtar për të marrë pjesë në Seminarin e përbashkët të Nën- Komisionit për Marrëdhënie Ekonomike dhe Transatlantike dhe Grupit Special të Mesdheut dhe Lindjes së Mesme të Asamblesë Parlamentare të NATO-s, i cili do të mbahet në Romë (Itali), nga data 22-25 nëntor 2017.

2. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit, akomodimit (me tejkallim të rezervimit paraprak) dhe mëditjet për të lartpërmendurit në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

6. Kërkesa e deputetit Hajdar Beqa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Gjermani

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Hajdar Beqa i lejohej udhëtimi zyrtar për të marrë pjesë në takimet me zyrtarë të Odës Federale të Noterëve të Gjermanisë lidhur me finalizimin e Projektligjit për Noterinë, të cilat do të mbahen në Berlin, Gjermani nga data 20-22 nëntor 2017.

2. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe mëditjet për të lartpërmendurin në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

7. Kërkesa e ish-drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsionit, z. Hasan, Preteni për kompensimin e pagës kalimtare

Kryesia e shtyu shqyrtimin e kërkesës së ish Drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsionit z. Hasan Preteni për kompensimin e pagës kalimtare.

8. Kërkesa e kryetarëve të grupeve parlamentare për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të Kryesisë së Kuvendit nr. 4-V-46/K, të datës 14 qershor 2011

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, vendosi që grupet parlamentare të kenë staf politik në bazë të formulës, si në vijim: Deri në dhjetë deputetë - një (1) person staf politik; deri në njëzet deputetë - dy (2); deri në tridhjetë - tre (3). Ky vendim hyn në fuqi që nga data 1 janar 2018.

9. Kërkesa e z. Faton Mehmetaj për mbështetje financiare për përkthimin dhe botimin e librit “Prijës Fetarë dhe Shpirtërorë Shqiptarë - Bashkëjetesa ndërjetare dhe kontributi i tyre kombëtar”

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Z. Faton Mehmetaj mbështetet financiarisht në shumën prej 3 000€ për nevojat e përkthimit dhe botimin në gjuhën angleze të librit “Prijës Fetarë dhe Shpirtërorë Shqiptarë - Bashkëjetesa ndërjetare dhe kontributi i tyre kombëtar”.

2. Mjetet e parapara në pikën një (1) të këtij vendimi ndahen nga kategoria ekonomike: Subvencione dhe transfere dhe transferohen në xhirollogarinë bankare të OJQ ISGJS me Nr. 1701001600038106, NLB Prishtina.

10. Kërkesa e Shoqatës “Miq të Amerikës” për mbulimin e shpenzimeve për organizimin e evenimentit “Dita e Falënderimeve”

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Shoqata “Miq të Amerikës” mbështetet financiarisht, në shumën prej 1 500€ për organizimin e evenimentit “Dita e Falënderimeve”, e cila do të organizohet më 23 nëntor 2017, në Prishtinë.

2. Mjetet e parapara në pikën një (1) të këtij vendimi ndahen nga kategoria ekonomike: Subvencione dhe transfere dhe transferohen në xhirollogarinë bankare me Nr.1501001009660807, Raiffaisen Bank.

11. Kërkesa e z. Don Viktor Sopi, drejtor gjeneral i “Caritas Kosova” për mbështetje organizative dhe financiare për realizimin e organizimit të 25-vjetorit të “Caritasit” në Kosovë

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. OJQ-ja “Caritas Kosova” mbështetet financiarisht në shumën prej 5 000€, si dhe i ofrohet mbështetje logjistike për organizimin e shënimit të 25-vjetorit të “Caritasit” në Kosovë, i cili do të organizohet më 8 dhjetor 2017, në Prishtinë.

2. Mjetet e parapara në pikën një (1) të këtij vendimi ndahen nga kategoria ekonomike: Subvencione dhe transfere dhe transferohen në xhirollogarinë bankare të OJQ-së “Caritas Kosova”.

12. Kërkesa e Komisionit për Legjislacion për miratimin e tejkallimit të shpenzimeve për muajin prill 2017

Kryetari i njoftoi të pranishmit se kjo kërkesë është tërhequr nga shqyrtimi.

13. Kërkesa e znj. Shqipe Pantina, kryetare e Komisionit ad hoc, për lejimin e shpenzimeve të drekës së punës së këtij komisioni

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet kërkesa e znj. Shqipe Pantina, kryetare e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidateve për një (1) anëtar të Komisionit të Pavarur të Medieve lidhur me mbulimin e shpenzimeve për drekën e punës së këtij komisioni më datë 2 nëntor 2017, në shumën prej 163,60€, sipas faturës së D.P.H. GAGI CAFE me nr. 001499, datë 2.11.2017.

14. Rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa për transferin e mjeteve buxhetore për Radiotelevizionin e Kosovës për periudhën 1 tetor - 30 nëntor 2017

Kryesia u njoftua me shkrim nga Komisioni për Buxhet dhe Financa lidhur me shqyrtimin raportit të shpenzimeve për periudhën janar-shtator 2017 dhe Programin e shpenzimeve për periudhën 1 tetor deri më 31 dhjetor 2017 të Radiotelevizionit të Kosovës, si dhe me rekomandimin e bërë Ministrisë së Financave, respektivisht Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit, për transferin e mjeteve buxhetore nga llogaria e Fondit të Konsoliduar të Republikës së Kosovës, nga buxheti i Radiotelevizionit të Kosovës-kategoria ekonomike subvencione dhe transfere në llogarinë e RTK-së, nr. 1110101219060187, për periudhën 1 tetor deri më 30 nëntor 2017, në shumën prej 1 700 000 (një milion e shtatëqind mijë) €.

15. Njoftimi i Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit lidhur me shkresën e GP të Lëvizjes “Vetëvendosje”, datë 30 tetor 2017

Kryetari i njoftoi të pranishmit se Komisioni për Legjislacion e ka shqyrtuar kërkesën e GP të LVV-së lidhur me ndarjen e zyrave për akomodimin e grupeve parlamentare, si dhe ka kërkuar nga Kryesia e Kuvendit që të për këtë çështje të veprohet në pajtim me nenin 15, 13 dhe 20.6 të Rregullores së Kuvendit.

Lidhur me çështjen e lartshënuar diskutuan: kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, dhe deputetja Albulena Haxhiu, në emër të GP të LDK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesia, pas diskutimit për çështjen e lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Obligohet Administrata e Kuvendit që t'i ndërmarrë veprimet e nevojshme për sigurimin e hapësirave për akomodimin e grupeve parlamentare.

16. Kërkesa për lejimin e mjeteve buxhetore për aktivitetet e komisioneve ad hoc

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Komisioneve ad hoc, të formuara me vendim të Kuvendit të Republikës së Kosovës, u lejohen mjete financiare deri në 500€ për shpenzimet e aktiviteteve të këtyre komisioneve.

17. Propozim për një shtesë për të punësuarit në Kuvendin e Republikës së Kosovës

Kryesia, pasi e shqyrtoi propozimin e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Të punësuarve në Kuvendin e Republikës së Kosovës për angazhim të shtuar jashtë orarit të punës dhe performansës së Administratës së Kuvendit për vitin 2017 në mbështetje të trupave punues të Kuvendit: Kryesisë së Kuvendit, seancës plenare dhe komisioneve parlamentare, si dhe vlerësimeve në Raportin e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2016, t'u bëhet një kompensim proporcional për të gjithë të punësuarit.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 16:00 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale